REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.385/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit të mitur O.B. nga Gjakova, i përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor babai i tij T..B, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.SH., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.B., jurist, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.431/15 të datës 13.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.431/15 i datës 13.11.2017, në pikën I (një) të dispozitivit në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit jomaterial në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, **VËRTETOHET.**

II.APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "EE..." në Prishtinë, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.431/15 i datës 13.11.2017, në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit përkitazi me kompensimin e dëmit material në emër të ndihmës së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim:

DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, që paditësit O.B. nga Gjakova, në emër të dëmit material të cilin e ka pësuar në aksidentin e trafikut të datës 30.10.2013, nga baza e auto përgjegjësisë, t'ia paguaj shumat si vijon:

-në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 150.00 €uro.

-në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 42.00 €uro.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit përtej shumave të gjykuara *refuzohet si e pabazuar*.

IV. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "EE..." në Prishtinë, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.431/15 i datës 13.11.2017, në pikën III (tre) të dispozitivit përkitazi me shpenzimet e procedurës kontestimore ashtu që ***Detyrohet*** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 248.70 €uro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për shpenzime të procedurës mbi shumën e gjykuar refuzohet si e pa bazuar.

V. Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.431/15 të datës 13.11.2017, në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit të mitur O.B. nga Gjakova, ashtu që e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit t'ia kompensoj shumën prej 3,100.00 €uro, me kamatën përkatëse ligjore 3.5% në vit, e cila fillon të rrjedhë nga data 17.10.2017 (data e precizimit të kërkesëpadisë) e tutje deri në pagimin definitiv, krejt këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë dhe atë për këto kritere të dëmit:

- për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 1,350.00 €uro
- për frikën e përjetuar, shumën prej 1,200.00 €uro
- për ndihmën e personit të tretë, shumën prej 500.00 €uro
- për ushqim të përforcuar, shumën prej 50.00 €uro

Në pjesën e dytë të dispozitivit kërkesëpadinë e paditësit të mitur O.B. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material paditësit të lartëpërmendur t'ia kompensoj edhe pjesën tjetër të mbetur, shumën prej 8,105.00 €uro, me kamatë përkatëse ligjore e ka refuzuar si të pathemeltë dhe atë për këto kritere të dëmit:

- për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 4,150.00 €uro
- për frikën e përjetuar, shumën prej 2,800.00 €uro
- për ndihmën e personit të tretë, shumën prej 500.00 €uro
- për ushqim të përforcuar, shumën prej 55.00 €uro
- për terapi fizikale dhe shërim klimatiko- mjekësor, rehabilitim shumën prej 500.00 €uro

Në pikën III (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, që paditësit të mitur O.B. nga Gjakova, në emër të shpenzimeve procedurale t' ia kompensoj shumën prej 829.00 €uro, në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, kurse pjesën tjetër përtej shumës së aprovuar e ka refuzuar si të pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim apo të njëjtin ta ndryshojë.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të padituris është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi i mitur O.B., i përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor - babai T..B nga Gjakova, me datë 02.10.2015, në gjykatën e shkallës së parë nëpërmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EE..." në Prishtinë, për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 30.10.2013, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.431/15 të datës 13.11.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njejtit.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se meqë në mes palëve ndërgjyqëse ishte kontestuese baza dhe lartësia e kërkesëpadisë për të gjitha kriteret e dëmit për paditësin e mitur, gjykata ka nxjerr dhe administruar prova për vërtetimin e fakteve kontestuese.

Lidhur me të provuarit e bazës së kërkesëpadisë, përkatësisht kontributit që kishin pjesëmarrësit në aksidentin e ndodhur në shqyrtimin kryesor të mbajtur, gjykata e shkallës së parë në cilësi të provës materiale ka bërë administrimin e ekspertizës së komunikacionit të datës 17.07.2017 të punuar nga grupi i ekspertëve të Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, përkatësisht nga Prof.dr. A.SH., Mrc. A.A. dhe Msc. G.H., të cilët kanë konstatuar se në shkaktimin e aksidentit ka kontribuar lëshimi nga pakujdesia – dalja e befasishme me vrap në rrugë e paditësit, pa u siguruar se një veprim të tillë mund ta bëjë pa rrezikuar së pari veten e pastaj sigurinë në trafik. Grupi i ekspertëve poashtu ka dhënë mendimin se duke pasur parasysh që ngasësi ka vozitur automjetin në vendbanim dhe se rreth rrugës gjenden shtëpi banimi, e bazuar në rrethanat e ndodhjes së aksidentit, veçanërisht në të dhënën se para se të vijë në kontakt me këmbësorin ka parë daljen e topit në rrugë, është dashur që të alarmohet për një kujdes të shtuar që pas topit mund të pasojë dalja e fëmijës në rrugë. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimkin e aktgjykimit të atakuar ka shtuar se gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 323 të LPK-së dhe parimit të drejtshmërisë ka ardh në përfundim se në rastin konkret në mes të pjesëmarrësve në aksident ekziston përgjegjësia e ndarë dhe atë 30% për ngasësin e automjetit, përkatësisht të siguruarin e të paditurës ndërsa për paditësin e mitur përgjegjësia prej 70%, duke vlerësuar se i njejti ka përgjegjësi primare dhe atë bazuar në mendimin e ekspertëve.

Lidhur me të provuarit e lartësisë së kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit si provë ka administruar mendimin profesional të ekspertit Dr. B.S. – ortoped dhe Dr. A.Z. – neuropsikiatër, dhënë në seancën e datës 21.09.2017, të cilët pas ekzaminimit të

drejtpërdrejtë bërë paditësit dhe shikimit të dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës kanë konstatuar se paditësi O.B. ka pësuar lëndime të natyrës së rëndë , si pasojë e të cilave ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaqërisht të rëndë që kanë zgjatur 5 minuta, dhimbje të intensitetit të rëndë 1 orë, dhimbje të intensitetit të mesëm 7 ditë dhe dhimbje të intensitetit të ulët për 50 ditë. Paditësi poashtu si pasojë e aksidentit ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur 1 muaj pas aksidentit, frikë të intensitetit jashtëzakonisht të lartë si ajo primare dhe sekondare që shfaqen me frikë nga vdekja, frikë të intensitetit të mesëm që paraqitet me frikë nga invaliditeti i përhershëm, frikë të intensitetit të ulët që paraqitet me shqetësime neurotike gjatë zhurmave të ndryshme në komunikacion siç janë sirena, zhurma e frenimit të gomave etj. Sipas ekspertëve mjekësor, paditësi si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 50 ditë ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 2 javë.

Mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor, gjykata e shkallës së parë i ka falur besimin e plotë, duke vlerësuar se përmban elementet e nevojshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, duke përfshirë edhe arsye të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve vendimtare sipas çështjes kontestimore në fjalë.

Gjykata e shkallës së parë në fund ka shtuar se pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh dhimbjet e përjetuara fizike, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve, intensitetin e frikës e duke marr për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, sidomos përgjegjësinë e ndarë në mes të pjesëmarrësve në aksidentin e shkaktuar, e duke u bazuar në kriteret dhe masat për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material dhe material të cilat i aplikojnë kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë, praktikën gjyqësore si dhe në dispozitën ligjore të nenit 323 të LPK-së,vendosi ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit.

Sa i përket pjesës refuzuese përkitazi me kompensimin e dëmit në emër të shërimit klimatik, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se e ka refuzuar kërkesën e paditësit nga fakti se i njëjti nuk ka ofruar prova materiale (faturë apo profaturë) të lëshuar nga institucionet shëndetësore se ka shpenzuar lidhur me shërimin klimatik, ndërsa për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar se është bazuar në kontributin e paditësit në shkaktimin e aksidentit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të padituërës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, qoftë për themelësinë e kërkesëpadisë por edhe lartësinë e saj, ku në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet pretendimi për

këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për secilën kategori të dëmit në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar në një pjesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të padituërës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ku baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar nga ekspertiza përkatëse me të cilën janë përcaktuar rrethanat e ndodhjes së aksidentit dhe kontributi i të dy palëve në shkaktimin e aksidentit, ndërsa lidhur me lartësinë e dëmit i ka administruar të gjitha provat si ekspertizat mjekësore nga lëmi i ortopedisë dhe neuropsikiatrisë, të cilat në mënyrë të qartë dhe precize kanë sqaruar për të gjitha kategoritë e dëmit, natyrën dhe llojin e lëndimeve, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, nevojën për ndihmë të huaj dhe ushqim të përforcuar, të cilat ekspertiza i ka vlerësuar edhe kjo gjykatë si profesionale, por që nga gjendja e vërtetuar faktike, është zbatuar gabimisht e drejta materiale në pjesën e kërkesëpadisë, ku aktgjykimi është dashur të ndryshohet.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të konstatuar, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve trupore të cilat i ka pësuar paditësi O.B. në aksidentin e ndodhur, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit si intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e manifestimit të frikës, të cilat i ka pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur, sipas gjetjeve dhe mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor, e duke marrë për bazë edhe vet kontributin e paditësit në rastin e ndodhur, por edhe praktikën e deritanishme gjyqësore, rezulton se shuma e gjykuar paditësit në emër të dëmit jo material për këto kategori të dëmit është në përputhje të plotë me qëllimin e kompensimit. Për këto kategori të dëmit jo material gjykata e shkallës së parë del të ketë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumës së gjykuar dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmit që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla, me çka gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë e ka vërtetuar duke vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit duke marrë pjesërisht si të bazuar pretendimin ankimor të t ‘padituërës, me pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar edhe në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material në emër të ushqimit të përforcuar dhe ndihmës së personit të tretë, duke ia gjykuar paditësit për këtë lloji dëmi material shumat si në vijim: për ushqimin e përforcuar shumën prej 42.00 €uro, ndërsa për ndihmën e personit të tretë shumën prej 150.00 €uro, duke u bazuar në nevojën dhe kohëzgjatjen për ushqim të përforcuar të pasur me vitamina dhe minerale, në mënyrë të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të paditësit si dhe nevojën dhe kohëzgjatjen për ndihmën e personit të tretë, ndërsa pjesën tjetër përtej shumës së aprovuar për këto kategori të dëmit e refuzoi si të pabazuar duke u bazuar në kontributin e paditësit gjegjësisht përgjegjësinë e ndarë të këtu palëve ndërgjyqëse në shkaktimin e aksidentit Kjo gjykatë vlerëson se shpërblimi për këto kategori të dëmit, zakonisht është e pamundur të dëshmohet me fatura, ngase ushqimi i përforcuar zakonisht është e pamundur të ndahet nga ushqimi i zakonshëm dhe ndihma e personit të tretë zakonisht ofrohet nga një person

familjar, por duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, praktikën e mirë gjyqësore dhe koston për ushqim në Kosovë, e që kjo kategori është e pranuar edhe nga praktika e kompanive të sigurimeve, gjykata e shkallës së dytë pretendimet ankimore në këtë drejtim i refuzoi si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës sipas pretendimit ankimor të t' padituresë ka vendosur si në pikën IV (katër) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e atakuar edhe sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe duke i gjykuar paditësit shumën prej 248.70 €uro, bazuar në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së, ngase shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk ishin në përputhje me këtë dispozitë ligjore e duke u bazuar në kontributin e paditësit gjegjësisht përgjegjësinë e ndarë të këtu palëve ndërgjyqëse në shkaktimin e aksidentit.

Pika II (dy) e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, e cila i referohet pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar nga ana e kësaj gjykate, pasi që aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë nuk është goditur me ankesë nga pala ankuese.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e) lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.385/18 më datë 06.07.2021

Kryetarja e kolegjit

Halide Reka d.v,